

Regjistrimi i Përgjithshëm i Njësive Ekonomike Bujqësore

Akronime

INSTAT -	Instituti i Statistikave
MBZHR -	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAO -	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
RNjEB -	Regjistrimi i Njësive Ekonomike të Bujqësisë
NjEB -	Njësi Ekonomike të Bujqësore
LRB - Juridike	Lista Regjistrimit te Subjekteve Bujqësore Ekonomike/Subjekteve
ZR -	Zonave të Regjistrimit
RSF -	Regjistri statistikor I fermës
OMR -	Optical Mark Recognition
ICR -	Intelligent Character Recognition
QKR -	Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)

1. Hyrje

Në Tetor të vitit 2012, në Republikën e Shqipërisë, u realizua Regjistrimi i Njësive Ekonomike të Bujqësisë (RNjEB), i cili është një aktivitet i gjerë statistikor për grumbullimin, përpunimin dhe botimin e të dhënave mbi strukturën e Njësive Ekonomike Bujqësore (fermat) me aktivitet në Shqipëri. RNjEB është pjesë integrale e sistemit të statistikave bujqësore, metodologjia e të cilit është në përputhje me standardet ndërkombëtare të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) dhe me legjislacionin e BE-së: Rregulloren (EC) Nr. 1166/2008 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për anketat e strukturës së fermës dhe metodat e prodhimit bujqësor.

Censuset zakonisht realizohet një herë në 10 vjet. Në këtë aktivitet u mbledhën të dhëna strukturore të fermave bujqësore/blegtorale, si madhësia e njësisë ekonomike bujqësore, përdorimi i tokës, numri i krerëve të blegtorisë, ujitja, forcat e punës, ditët e punës në bujqësi dhe të tjera.

2. Organet zbatuese dhe monitoruese

RNjEB u organizua nga Instituti i Statistikave (INSTAT) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), sot Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, (MBZHR). INSTAT ishte organi kryesor përgjegjës dhe zbatues për Regjistrimi e Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është pjesë e grupit të punës në përgatitjen e pjesës metodologjike, për hartimin e pyetësorit dhe udhëzuesit përkatës. Instrumentet teknike të përdorura për aktivitetin (Pyetësori dhe Udhëzuesi) janë në përputhje me metodologjinë e Eurostat-it dhe Rregulloren 1166/2008 të Këshillit të Evropës, për vrojtimit për Strukturën e Fermave si dhe rekomandime të FAO.

Në zbatim të Ligjit Nr 10201, date 17.12.2009 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për regjistrimin e përgjithshëm të bujqësisë u krijua Komisioni Qendror i Regjistrimit si organi më i lartë në drejtimin dhe organizimin e punës për kryerjen e RNjEB. Po në zbatim të këtij ligji u krijuan Komisionet e Regjistrimit në Qarqe si dhe Komisionet e Regjistrimit në Bashki dhe Komuna.

Regjistrimi i Bujqësisë, është financuar hartuar dhe zbatuar me mbështetjen teknike dhe financiare të Bashkimit Evropian, Qeverisë Suedeze dhe Qeverisë Shqiptare.

3. Qëllimi kryesor

Regjistrimi i njësive ekonomike bujqësore: Ofron informacion të përditësuar dhe të saktë statistikor mbi një grup të gjerë karakteristikash për të gjitha njësitë që zhvillojnë veprimtari bujqësore në territorin e Republikës së Shqipërisë; Të nxjerrë në pah karakteristikat kryesore strukturore të njësive ekonomike bujqësore dhe blegtorale, si sistemi i drejtimit, forma organizative dhe juridike, sipërfaqja e tokës dhe mënyra e punimit të tokës, kulturat e praktikuara dhe numri i krerëve të blegtorisë, mjetet mekanike të përdorura, forcat e punës

dhe aspekte të tjera; Të krijojë Regjistrin Statistikor të Fermave, si bazë për kryerjen e anketave statistikore për Ekonomitë Bujqësore; Rezultatet e Regjistrimit kontribuojnë në përmirësimin e statistikave bujqësore në të ardhmen.

4. Njësia e vrojtimit

Regjistrimi përfshin të gjitha njësitë ekonomike, që kanë në përdorim tokë bujqësore apo që mbarështojnë bagëti, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në konceptin njësi ekonomike bujqësore, përfshihen njësitë tekniko ekonomike të vendosura nën një drejtim unik, e përbërë nga terreni, edhe pse në ngastra (parcela) jo të vazhdueshme, në të cilën realizohet prodhimi bujqësor dhe blegtoral, drejtuar nga një person fizik ose juridik (person i vetëm ose familje të bashkuara), ent shtetëror, apo të tjerë.

Si njësi ekonomike bujqësore konsiderohen dhe njësitë ekonomike ekskluzivisht blegtorale në të cilat zhvillohet mbarështimi i kafshëve pa pasur në administrim sipërfaqe bujqësore.

5. Fusha e vrojtimit

Fusha e vrojtimit e regjistrimit të përgjithshëm të bujqësisë, përfshin të gjitha njësitë ekonomike që plotësojnë definicionin e njësive ekonomike bujqësore, blegtorale pavarësisht nga madhësia.

Përfshihen nga fusha e vrojtimit:

- Terrenet e njësive ekonomike bujqësore që nuk janë përdorur për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, pra kur ato janë përdorur për qëllime të tjera;
- Njësitë ekonomike bujqësore tërësisht të braktisura, për emigracion, të larguar jashtë rrethit apo shkaqe të tjera, edhe pse toka jep akoma një prodhim spontan,
- Njësitë të cilat kanë përdorur si sipërfaqe bujqësore vetëm kopshte shtëpie që nuk i kalon 200 m²: (nën këtë kufi minimal, njësitë nuk konsiderohen si njësi ekonomike bujqësore dhe rrjedhimisht nuk regjistrohen si të tilla),
- Njësitë të cilat përbëhen vetëm nga: pyje (sipërfaqe të pyllëzuara), parqe dekorative apo shplohëse, kujtudo që mund t'i përkasin,
- Aktivitete mbarështimi të kafshëve shtëpiake (qen, mace etj),
- Ahure hipizmi (tokë e përdorur për ushtrimin e kuajve për gara), nëse nuk kanë aktivitete mbarështimi,
- Qendra për tregtimin e blegtorisë dhe thertoreve që nuk kryejnë aktivitete zooteknike.

6. Periudha referuese

Të dhënat për sipërfaqen e tokës të shfrytëzuar i referohen vitit bujqësor, 1 Tetor 2011 – 30 Shtator 2012. **Sipërfaqja e tokës në shfrytëzim** përbëhet nga: toka bujqësore (e shfrytëzuar dhe e pashfrytëzuar), toka pyjore dhe toka jo-pjellore.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në dispozicion të Njesisë Ekonomike Bujqësore (NjEB) është toka në pronësi të bartësit ose anëtarëve të tjerë të NjEB-së, si dhe toka në pronësi të të tjerëve dhe e shfrytëzuar nga NjEB-ja, pavarësisht nëse toka është kultivuar ose jo. Të

dhënat janë regjistruar për tokën e NjEB-së, e cila ka të drejtë ta shfrytëzojë atë në kohën e RNjEB-së, pavarësisht nëse ato të drejta janë të drejta pronësore, të drejta kontraktuale (p.sh. me qira, shfrytëzim) ose të drejta të tjera. Toka në pronësi e anëtarëve të NjEB-së dhe e dhënë me qira të tjerëve, nuk është regjistruar në sipërfaqen gjithsej të tokës në dispozicion, por është regjistruar te personi që e shfrytëzon atë, pa marrë parasysh vendndodhjen e tokës.

Të dhënat për numrin e kafshëve i referohen gjendjes të numrit të kafshëve në Njësinë Ekonomike Bujqësore më 1 Tetor të vitit 2012, pavarësisht nga pronësia. Kafshët mund të jenë në pronë (në sipërfaqe bujqësore të shfrytëzuara ose në vendstrehimet e kafshëve, të përdorura nga NjEB-ja) ose jashtë saj (në kullota të përbashkëta ose gjatë shtegtimit, etj.). Nuk janë përfshirë kafshët shtëpiake dhe kafshët e tjera, përveç kuajve, që nuk përdoren në prodhimtari, ose që nuk përdoren për aktivitete fitimprurëse, d.m.th. përdoren vetëm për qëllime të aktiviteteve të lira (zbavitje) të familjes së bartësit.

7. Instrumentet e Regjistrimit të Bujqësisë

Instrumentet teknike për Regjistrimin e Bujqësisë (Pyetëtori dhe Udhëzuesi); janë hartuar në përputhje me Programin Botëror për Regjistrimin e Bujqësisë 2010 (FAO) dhe metodologjinë e Eurostat-it për kryerjen e Anketës së Strukturës së Fermave: Rregullorja (KE) Nr. 1166/2008. Në regjistrimin e bujqësisë, është përdorur një pyetësor i vetëm si për ekonomitë familjare bujqësore dhe subjektet juridike. Udhëzuesi i regjistrimit të bujqësisë përmban të gjitha shpjegimet e nevojshme për qëllimin e regjistrimit, konceptet, përkufizimet dhe detajet për detyrat e pjesëmarrësve në regjistrimin e bujqësisë. Ai jep informacion të detajuar mbi plotësimin e pyetësit, dhe si të përdoren instrumentet e tjera të regjistrimit (raportet ditore dhe përmbledhëse, hartat, raporte ditore (RD), letër informuese, letër njoftuese, raportin e pranim-dorëzimit të materialeve, Listën e Ekonomive/Subjekteve Juridike për t'u vizituar (LRB).

Hartat, e territorit të Shqipërisë janë përgatitur nga INSTAT (sektori I hartografisë), bazuar në imazhet satelitore, si dhe të freskuara me të dhënat e terrenit nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në vitin 2011. Hartat kanë mbuluar të gjithë territorin e vendit, për të cilat regjistruesit, kontrollorët, mbikëqyrësit ishin përgjegjës.

8. Testim Pilot

INSTAT në bashkëpunim me MBZHR kreu në muajt Qershor dhe Korrik 2011 "Testimin e metodologjisë". Mbi bazën e gjetjeve të tyre u bë rishikimi, përmirësimi i pyetësit dhe i manualit. Në vijim u realizua Vrojtimi Pilot (Dhjetorit 2011).

Qëllimi i Vrojtimit Pilot ishte: Vlerësimi dhe ndarja e qartë e përgjegjësive dhe detyrave ndërmjet operatorëve të terrenit; Verifikimi i mjeteve dhe mekanizmave të përcaktuar për monitorimin e aktivitetit në terren dhe sistemimin e raportimit; Përmirësimi i mëtejshëm i pyetësit dhe manualit; Verifikimi i kohës së nevojshme për plotësimin e pyetësit, ICR

(testimi i sistemit të skanimit); Testimi i sistemit të IT për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave.

9. Hartimi i listave të njësive ekonomike bujqësore.

Hapat kryesorë të procesit:

Sektori familjar

Nga baza e të dhënave të Censurit të Popullsisë dhe Banesave i kryer në Tetor 2011, u identifikuan afërsisht 327.000 NjEB potenciale të cilat janë përgjigjur që janë të përfshira në veprimtari bujqësore ose blegtorale përgjatë këtij Censusi.

Nga fushata e identifikimit të fermave blegtorale e kryer në vitin 2011 nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, u identifikuan afërsisht 20.000 njësi ekonomike blegtorale, duke shënuar një përmirësim të ndjeshëm të mbulimit.

Pastrimi përfundimtar i bazës së të dhënave për listën e NjEB-ve u krye në muajin gusht 2012: Në fund të procesit, lista e NjEB-ve potenciale për sektorin familjar rezultoi në 344.647 njësi për intervistim.

Hartimi listës për sektorin familjar ishte me rëndësi të madhe, duke qenë se: (i) njësitë ekonomike familjare (NjEF) rezultuan që përfaqësonin 99% të totalit të të gjitha NjEB-ve; dhe (ii) kjo listë përfaqësonte një input kryesor për të gjitha detyrat përgatitore në lidhje me RNjEB-në (shpërndarja e Zonave të Regjistrimit (ZR) midis operatorëve që punojnë në terren, nevojat për rekrutim, vendosja e sistemit GIS dhe printimi i hartave, prezantimi i sistemit të menaxhimit për aktivitetin e regjistrimit të përgjithshëm të NjEB dhe logjistika për sistemin Web-GIS për monitorimin e aktivitetit në terren.

Sektori jo-familjar - Fermat e mëdha dhe ndërmarrjet

Për hartimin e listës me fermat e mëdha dhe ndërmarrjet bujqësore, informacioni u mor nga Regjistri i biznesit të INSTAT. 754 ndërmarrje rezultuan nga ky regjistër ferma me NIPT, të regjistruara si biznese në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR); dhe 38 Njësi si “ferma të mëdha me NIPT” u morën nga MBZHR.

Nga regjistri i fermave të MBZHR, u morën dhe 3.269 NjEB potenciale të identifikuar si “ferma të mëdha pa NIPT”.

Të tjera subjekte për regjistrim;

Në listë për regjistrim u përfshinë dhe institucione publike dhe ato fetare të cilat zotërojnë osë kanë në përdorim sipërfaqe bujqësore ose ushtrorë aktivitet blegtoral.

Lista përfundimtarë që u përgatit për RNjEB-në përfshinte gjithsej 348.737 NjEB potenciale.

10. Implementimi i aktivitetit

10.1 Struktura organizative e punës në terren

Puna në terren është realizuar në përputhje me Ligjin për RNjEB dhe në bazë të përvojës së fituar në Regjistrimin e Popullsisë, Banesave 2011, si dhe në vrojtime të tjera statistikore të kryer më parë. Gjatë punës në terren kanë marrë pjesë 3.527 anketues, 697 kontrollorë dhe 69 mbikëqyrës. Mbikëqyrësit dhe kontrollorët janë rekrutuar nga INSTAT, ndërsa anketuesit janë rekrutuar nga komunat/bashkitë duke ndjekur udhëzimet dhe kriteret e INSTAT. Kandidatët duhet të përmbushnin kriteret themelore: të jenë shtetas shqiptar, të jenë të arsimuar, preferohen ata me shkollë të mesme bujqësore ose me Universitet Bujqësor, të kenë përvojë pune, dhe të jenë banorë në vendbanimin përkatës, ku ata/ato është menduar të punojnë. Të gjithë kandidatët, janë testuar paraprakisht në INSTAT, ndërsa përparësi ju është dhënë kandidatëve me përvojë në fushën e bujqësisë.

Puna në terren ka filluar më 1 Tetor 2012 dhe ka përfunduar më 31 Tetor 2012.

Organizimi i punës në terren është bazuar në ndarjen e territorit të Shqipërisë në Zona Numërimi (ZR). e cila mundësoi ndarjen e punës për të gjithë anketuesit, kontrollorët dhe mbikëqyrësit.

10.2 Trajnimi

Një rëndësi e veçantë ju kushtua trajnimit të personelit që u angazhua gjatë regjistrimit të njësive ekonomike bujqësore. Kjo fazë përfshiu trajnimin e stafit të grupit teknik të punës, trajnimin e mbikëqyrësve, trajnimin e kontrollorëve të komunave dhe trajnimin e anketuesve. Gjithashtu në trajnim morën pjesë dhe stafi i INSTAT nga zyrat rajonale.

Stafi i zyrave rajonale dhe stafi i INSTAT (jo të sektorit të Bujqësisë) të cilët u përfshinë RNjEB janë trajnuar nga stafi i grupit teknik për 5 ditë gjatë muajit Shtator në Tiranë. Trajnimet e stafit në terren janë realizuar me metodën "Kaskadë". Ekipi i grupit teknik të punës së RNjEB-së ka trajnuar mbikëqyrësit, mbikëqyrësit kanë trajnuar kontrollorët nën monitorimin e grupit teknik dhe stafit të INSTAT dhe kontrollorët kanë trajnuar anketuesit nën monitorimin e grupit teknik dhe stafit të INSTAT. Trajnimi ka zgjatur nga pesë (5) ditë për secilin nivel. Mbikëqyrësit janë trajnuar në INSTAT, kontrollorët janë trajnuar në nivel Qarku, dhe anketuesit janë trajnuar në nivel rrethi. Të gjitha trajnimet janë mbikëqyruar nga grupi teknik i punës për regjistrimin e bujqësisë. INSTAT dhe komisionet e regjistrimit në qark dhe rreth kanë ndihmuar në sigurimin e sallave për trajnime dhe kanë ofruar asistencë teknike për trajnime.

10.3 Komunikimi dhe Informimi

Publiciteti për RNjEB dhe fushata e ndërgjegjësimit u zhvilluan në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit dhe Teknologjisë së Komunikacionit, dhe me Ministrinë e Brendshme.

Në gusht të vitit 2012, INSTAT-i organizoi një takim me prefektët e 12 Prefekturave, kryetarët e bashkive dhe kryetarët e komunave, në cilësinë e tyre si prestarë të komisioneve lokale të RNjEB. Takimi pati si qëllim informimin në lidhje me procesin e zbatimit të RNjEB, kriteret për përzgjedhjen e personelit dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të regjistrimit.

Posterat dhe fletëpalosje me logon dhe sloganin e RNjEB ("Zëri yt, e ardhmja juaj") u printuan dhe u shpërndanë në të gjithë Shqipërinë, duke nisur nga Tirana me panairin ndërkombëtar të Agrobiznesit, "Panairi i Bujqësisë" i mbajtur në shtator të vitit 2012.

Promovimi i regjistrimit në televizionet kombëtare dhe lokale nisi nga fundi i muajit shtator dhe vijoi gjatë gjithë muajit Tetor 2012, me anë të dy spoteve publicitare, një kryesor dhe një tjetër më i shkurtër në mbështetje të të parit.

10.4 Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave u realizua në periudhën 1-31 Tetor 2012. Mbledhja e të dhënave është kryer me metodën "derë-më-derë" dhe duke përdorur metodën e intervistimit drejtpërdrejt. Metoda "derë-më-derë" është mbështetur në ZR, hartat përkatëse me ndërtesat me numra të përgatitura nga INSTAT dhe listat për çdo ZR.

10.5 Monitorimi i mbledhjes së të dhënave

Duke qenë se Regjistrimi i përgjithshëm është një projekt i madh, me afate kohore të përcaktuara, me shumë aktivitete që ndërlidhen me njëri-tjetrin, përdorimi i një sistemi modern për menaxhimin e tij ishte me rëndësi të madhe.

Një qasje novatore për monitorimin e mbulimit të punës në terren ishte përdorimi i mesazheve me SMS. Çdo person i strukturës së terrenit u pajis me një kartë SIM që mundësonte komunikimin e lirë mes tyre. U përpunua një program GIS, në internet, i cili përditësohej çdo ditë me shifra që vinin nga SMS-të.

Gjatë gjithë operacioneve në terren (Tetor 2012), INSTAT-i monitoroi mbulimin e Regjistrimit të Përgjithshëm përmes sistemit të raportimit me SMS dhe përmes sistemit të monitorimit interaktiv GIS.

Sistemi i monitorimit GIS ishte një instrument i dobishëm për monitorimin e ecurisë së Regjistrimit nga ana e mbikëqyrësve të terrenit. Të gjithë mbikëqyrësit kishin llogaritë e tyre për të hyrë në sistemin GIS të monitorimit, duke pasur kështu mundësi të monitoronin ecurinë e personelit të tyre dhe zonave të regjistrimit. Informacioni i dhënë nga çdo anketues me anë të SMS-ve ruhej automatikisht në një bazë qendrore të dhënash dhe sistemi GIS i monitorimit përditësohej çdo ditë totalin e shifrave të arritura. Gjatë periudhës së regjistrimit, INSTAT –i hartoi një raport përmbledhës ditor me të dhëna të një dite më parë të siguruar nga SMS-të. Raportet tregonin të dhënat e mbledhura, sipas rretheve dhe në rang bashkie.

11. Skanimi dhe verifikimi

Pyetësorët e RNjEB kalonin përmes skanimit optik nga sistemi i njohjes së markës optike Optical Mark Recognition (OMR) dhe teknologjisë së njohjes inteligjente të karaktereve Intelligent Character Recognition (ICR), me asistencën e operatorëve të trajnuar për të bërë verifikimin e të dhënave të kapura.

Gjatë muajit shtator 2011, u krijua një Qendër e re për Përpunimin e të Dhënave, me skanera 60 pc, skanera 10 pc të avancuar dhe 7 skanera optikë. Qëllimi i sistemit ishte të sigurohej një nivel më i lartë cilësor i të dhënave, si edhe të shkurtohej perioda për heqjen e të dhënave.

Sistemi ishte i përshtatur në gjuhën shqipe dhe për specifikat e pyetësorëve, për të garantuar një performancë më të mirë. Gjatë procesit të hedhjes së të dhënave u punësuan 100 operatorë. I gjithë procesi i përpunimit të të dhënave të pyetësorit të RNjEB u zhvillua gjatë periudhës Janar - Mars 2013. Në një afat kohor prej 3 muaj.

12. Përkufizimet kryesore

Regjistrimi i njësive ekonomike bujqësore (RNjEB)

Regjistrimi i Përgjithshëm i Bujqësisë është një aktivitet i gjerë statistikor i planifikuar, organizuar dhe zbatuar duke u mbështetur në kritere e përcaktime shkencore e bashkëkohore, për grumbullimin, përpunimin dhe botimin e të dhënave mbi strukturën e fermave bujqësore. Regjistrimi i përgjithshëm i bujqësisë është pjesë integrale e sistemit të statistikave bujqësore. Ai siguron informacion të përgjithshëm dhe të hollësishëm për të gjitha njësitë ekonomike bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore paraqet një nga momentet më të rëndësishme të statistikës bujqësore shqiptare.

Qëllimi i Regjistrimit të Përgjithshëm të Bujqësisë është krijimi i regjistrave të veçantë për bimët e arave, frutikulturën, vreshtarinë si dhe të blegtorinë sipas llojeve; gjedhë, të leshta dhe të dhirta, derra, njëthundrakë dhe shpendë.

Regjistrimi i Përgjithshëm i Bujqësisë kontribuonë në sigurimin e të dhënave bazë të qëndrueshme në kohë, si demografike ashtu dhe social-ekonomike, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për sektorin bujqësor.

Njësi ekonomike bujqësore (NjEB) e përcaktuar në nenin 4 të ligjit të regjistrimit në përputhje me përcaktimet e FAO-s dhe BE-së është një njësi e vetme, si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe ekonomike, e cila drejtohet nga një person i vetëm, ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Njësia ekonomike përcaktohet sipas kritereve të mëposhtme:

- Një njësi e vetme teknike dhe ekonomike: kjo i referohet përdorimit të të njëjtave mjete prodhimi (krahu i punës, toka, makineri dhe pajisje, ndërtesa etj.);
- Menaxhim i vetëm: sistemi i menaxhimit vendoset nga një person ose grup personash; kjo do të thotë që është një person ose grup personash përgjegjës në marrjen e vendimeve të aktiviteteve bujqësore të NjEB;
- Njësia është e angazhuar në aktivitete bujqësore si aktivitete të veta parësore, ose dytësore: aktivitetet bujqësore, sipas Klasifikimit Statistikor Evropian të Aktiviteteve Ekonomike (NACE Rev. 2), përfshijnë:
 - Rritje të bimëve jo të përhershme,
 - Rritje të bimëve të përhershme,
 - Shtim të bimëve,
 - Mbarështim të kafshëve,
 - Rritje të bimëve kombinuar me mbarështimin e kafshëve,
 - Mbajtje të tokës bujqësore në kushte të mira bujqësore dhe mjedisore.

Njësi Ekonomike Familjare nënkupton individin, bashkësinë familjare ose bashkësinë tjetër të personave (individëve), të cilët jetojnë së bashku dhe janë të vendosur tërësisht ose pjesërisht në një Ekonomi Familjare, si dhe ndaj të ardhurave dhe shpenzimet pjesërisht ose tërësisht së bashku.

Ekonomi Familjare Bujqësore është një familje, anëtarët e së cilës janë të angazhuar në prodhimtari bujqësore si aktivitete të tyre kryesor ose dytësor, kanë një menaxhim të vetëm dhe përdorin mjetet të përbashkëta të prodhimit, si: tokën, makinat, ndërtesat, etj. Një Ekonomi Familjare Bujqësore mund të prodhojë produkte bujqësore për shitje, konsum vetjak ose për të dyja.

Subjektet Juridike janë familje të bashkuara, bizneset individuale Institucione dhe forma të tjera organizative, me statusin e subjektit juridik, që janë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe kanë prodhimtari bujqësore, si aktivitete të tyre kryesor ose dytësor.

Drejtuesi i Njesisë Ekonomike Bujqësore

Person fizik ose juridik, përgjegjës ligjor dhe ekonomik për NjEB-në. Drejtuesi ka përgjegjësinë kryesore në menaxhimin e NjEB-së, mbarë risqet ekonomike dhe merr vendimet kryesore që kanë të bëjnë me aktivitetet bujqësor.

Menaxheri i njësisë ekonomike bujqësore

Person fizik përgjegjës për punët e përditshme financiare dhe prodhuese të NjEB. Menaxheri në përgjithësi, por jo gjithmonë, është vetë drejtuesi. Menaxheri mund të jetë një person tjetër, të cilit drejtuesi i ka besuar menaxhimin; p.sh. një anëtar i familjes së tij/saj, bashkëshorti i tij/saj, ose person që nuk ka lidhje familjare me drejtuesin, i punësuar.

PËRDORIMI I TOKËS

Të dhënat për sipërfaqen e tokës së përdorur i referohen **vitit bujqësor 1 Tetor 2011 – 30 Shtator 2012**.

Sipërfaqja e tokës të Njesisë Ekonomike Bujqësore (NJEK) përbëhet nga: Sipërfaqja e bujqësore e njesisë ekonomisë bujqësore është toka në pronësi të drejtuesit ose anëtarëve të tjerë të NJEK-së, si dhe toka në pronësi të të tjerëve dhe e përdorur nga NJEK-ja.

Të dhënat janë regjistruar për NJEK-të, që kanë në përdorim tokën në kohën e regjistrimit, pavarësisht nëse ajo është në pronësi, me të drejta kontraktuale (p.sh.koncesion, shfrytëzim) ose të drejta të tjera përdorimi.

Toka në pronësi e anëtarëve të NJEK-së dhe e dhënë me qira të tjerëve, nuk është regjistruar në gjithsej sipërfaqen e tokës të NJEK, por është regjistruar te personi që e shfrytëzon atë, pa marrë parasysh vendndodhjen e tokës.

Toka e përbashkët nuk është e përfshirë në të dhënat e grumbulluara me anë të pyetësorit të Censurit të bujqësisë. Të dhënat për tokën e përbashkët janë mbledhur me anë të pyetësorit të veçantë pranë njësive të pushtetit vendor.

Sipërfaqja bujqësore e përdorur i referohet sipërfaqes së përgjithshme të tokës së punueshme, kopshteve sipërfaqes me kultura drufrutore, dhe livadheve e kullotave të përhershme, të përdorura nga NJEK-ja, pavarësisht nga lloji i zotërimit.

Tokë e punueshme (arë) është toka e punuar (e pluguar ose e lëruar) rregullisht, zakonisht sipas një sistem qarkullimi bimor.

Nëse janë kultivuar bimë të ndryshme njëra pas tjetrës në të njëjtën sipërfaqe gjatë vitit bujqësor, sipërfaqja i caktohet "bimës kryesore". Bimë kryesore është ajo bimë që ka vlerën më të lartë të prodhimit. Nëse vlera e prodhimit nuk përcakton se cila është bima kryesore, atëherë "bimë kryesore" konsiderohet ajo që okupon tokën për kohë më të gjatë vitit bujqësor. Përrjashtohet sipërfaqja e mbjellë me kultura të dyta.

Qarkullimi bimor është praktika e rritjes alternative të kulturave bimore njëvjeçare në një fushë specifike sipas një modeli ose rendi të planifikuar në vitet prodhuese pasuese, kështu që kulturat e se njëjtës specie nuk rriten pa ndërprerje në të njëjtën fushë. Normalisht, kulturat bimore ndryshojnë çdo vit, por ato mund të jenë edhe shumëvjeçare (jonxha, terfile etj.). Për të dalluar tokën e punueshme nga kullotat dhe livadhet e përhershme përdoret *një praq prej pesë vitesh*.

Toka e punueshme përfshin drithërat, bishtajoret, bimët industriale, patatet, bimët foragjere, lulet dhe bimët dekorative, farërat dhe fidanet, perimet dhe kulturat e tjera të tokës së punueshme. Toka e punueshme gjithashtu përfshin edhe tokën djerr.

Kopshti është sipërfaqja e tokës për kultivimin e prodhimeve bujqësore, e dedikuar vetëm për konsum familjar të NJEK-së zakonisht e ndarë nga pjesa tjetër e tokës bujqësore.

Këto sipërfaqe janë shfrytëzuar për kultivimin e perimeve, bishtajoreve të freskëta, patateve, luleve, etj. Në këto sipërfaqe mund të ketë të shpërndarë edhe rrënjë të drufrutorëve dhe hardhi rrushi.

Vetëm një pjesë e prodhimeve bujqësore, që prodhohen në këtë sipërfaqe të tokës, mund të shiten nga NJEK-ja. Sipërfaqja e tokës, prodhimet bujqësore të së cilës shiten vazhdimisht

në treg, nuk përfshihen në kopshtet e shtëpive, ato përfshihen në kategoritë e të tjera, edhe kur një pjesë e prodhimeve është konsumuar nga anëtarët e NJEB-së.

Nuk janë përfshirë kopshtet zbukuruese (parqet dhe lëndinat me bar) dhe sipërfaqet e shfrytëzuara për prodhimin e foragjereve.

Tokë e zënë me drufrutorë në blloqe

Tokë e përdorur për bimë jo të rritura me qarkullim, përveç kullota dhe livadhe të përhershme, që zënë tokën për një periudhë të gjatë dhe prodhojnë për disa vite.

Kjo kategori përbëhet nga pemët frutore dhe arvore, vreshtat, ullinjët, agrumet dhe fidanishtet frutore.

Plantacionet e drufrutorëve janë sipërfaqe me pemë frutore, të mbjella në rreshta dhe me një distancë të caktuar ndërmjet rreshtave, që mundësojnë përdorimin e makinave dhe pajisjeve për pemëtoret dhe ku zakonisht ndërmerren masat agroteknike. Përfshihen: sipërfaqe me drufrutorë të degraduara.

Sipërfaqe me drufrutorë të degraduara janë ato blloqe drufrutorë të cilat nuk kanë dhënë prodhim për më shumë se 8 vjet.

Gjithsej numri i pemëve i referohet numrit të pemëve në prodhim dhe pemëve të reja, që ende nuk mund të japin fruta.

Vreshtat janë sipërfaqe të tokës të kultivuara me hardhi të rrushit, të destinuara për prodhimin e rrushit. Plantacionet e vreshtave janë sipërfaqe me hardhi rrushi me një distancë të caktuar ndërmjet rreshtave dhe ndërmjet hardhive, të cilat mundësojnë përdorimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, si dhe aplikimin e masave agroteknike.

Rrushi i tavolinës është varietet i rrushit, që kultivohet zakonisht për prodhimin e rrushit për konsum. Ndërsa rrushi për verë është varietet i rrushit, që kultivohet zakonisht për prodhimin e verërave.

Fidanishtet janë sipërfaqe të tokës të destinuara për prodhimin e fidanëve. Këtu janë përfshirë fidanishtet me fidanë të pemëve frutore, fidanët e hardhisë së rrushit, ullirit dhe agrumeve.

Livadhet janë sipërfaqe të tokës së kultivuar me kultura të përhershme (për pesë vjet ose më shumë) për rritjen e barërave të ndryshme të kultivuara (të mbjella) ose në mënyrë natyrale (vetëmbjellja) dhe që nuk janë të përfshira në qarkullimin e kulturave në NJEB. Livadhet mund të përdoren për kositje për sanë a silazh dhe më pas për kullotje.

Kullotat (kullotat natyrore) janë tokë e përdorur për kullotje, zakonisht në sipërfaqe të tokës me cilësi të ulët, për shembull në tokat kodrinore dhe me lartësi të madhe mbi nivelin e detit, të patrajtuara me masa agroteknike. Këto sipërfaqe, përdoren për kullotje ekstensive dhe nuk kositen. Këto sipërfaqe nuk janë të përshtatshme për numër të madh të bagëtive.

Toka e përbashkët është toka që nuk i takon drejtpërsëdrejti NJEB-së, por që në të aplikohen të drejtat e përbashkëta për tu përdorur. Ajo mund të përbëhet nga kullotat, livadhet ose toka tjetër. Në përgjithësi, toka e përbashkët është toka e shfrytëzuar bujqësore në pronësi të një autoriteti publik (shtetëror, komunal) këto të drejta ushtrohen në përgjithësi, në mënyrë të përbashkët me të tjerët.

Toka bujqësore e papërdorur i referohet tokës, e cila për arsye ekonomike e sociale nuk është kultivuar. Sipërfaqja që është shfrytëzuar më parë si tokë bujqësore dhe gjatë vitit referues, nuk është kultivuar për arsye ekonomike, sociale dhe/ose arsye të tjera, dhe e cila nuk është punuar në sistemin e qarkullimit të bimor, pra është tokë në të cilën nuk është aplikuar ndonjë aktivitet bujqësor. Normalisht, kjo tokë mund të shndërrohet në tokë të punueshme, duke përdorur burimet në dispozicion të NJEB-së.

Sipërfaqja e tokës pyjore i referohet sipërfaqes së mbuluar me drunj ose shkurre pyjore, që rriten në tokën pyjore, për nevojat e vetë NJEB-së.

Sipërfaqja e tokës jobujqësore i referohet të gjitha pjesëve të sipërfaqes së përgjithshme të tokës, që i përkasin NJEB-së dhe të cilat nuk përbëjnë as sipërfaqe toke bujqësore të shfrytëzuar, as sipërfaqe toke bujqësore të pashfrytëzuar, si dhe as sipërfaqe të tokës pyjore. Kjo është sipërfaqja e tokës, që nuk shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore, kjo është sipërfaqe e zënë me ndërtesa, oborre të fermave, shtigjet, guroret, ranoret, pellgjet, moçalishtet, kanalet dhe sipërfaqet e tjera.

Blegtoria dhe Kullotja

Të dhënat për numrin e kafshëve i referohen numrit të kafshëve në NJEB, gjendje më 1 Tetor të vitit 2012, pavarësisht në se janë në emër të mbartësit apo të një ruajtësi kafshësh. Kafshët mund të jenë në pronë (në sipërfaqe bujqësore të shfrytëzuara ose në vendstrehimet e kafshëve, të përdorura nga NJEB-ja) ose jashtë saj (në kullota të përbashkëta ose gjatë shtegtimit, etj). Nuk janë përfshirë kafshët shtëpiake dhe kafshët e tjera, përveç kuajve, që nuk përdoren në prodhimtari, ose që nuk përdoren për aktivitete fitimprurëse, d.m.th. përdoren vetëm për qëllime të aktiviteteve të lira (zbavitje) të familjes së bartësit.

Gjedhet mbi dy vjeç – meshkuj përfshijnë demat për mbarështim, për therje, për punë, transport, etj.

Mëshqerrat janë gjedhë femra, të moshës dy vjeç e më shumë, që ende nuk kanë pjell, edhe nëse ato janë të mbarsura në ditën e Regjistrimit.

Lopë qumështi- janë lopë që kanë pjellë (përfshirë edhe ato të moshës më pak se dy vjeç) dhe për shkak të racës së tyre, ose cilësive të veçanta, mbahen kryesisht për të prodhuar qumësht për konsum njerëzor, ose për përpunimin e qumështit. Këtu përfshihen edhe lopët për qumësht, në fund të aftësisë së tyre prodhuese, që momentalisht nuk mbahen për prodhimin e qumështit, por kanë dalë nga prodhimtaria e qumështit (laktacioni) dhe janë të destinuara për therje, pavarësisht se a janë majmur në periudhën ndërmjet laktacionit të fundit dhe therjes së tyre.

Lopët të tjera - janë krerët e gjedhëve femra të cilat kanë pjellë, dhe për shkak të racës së tyre ose cilësive të veçanta, mbahen kryesisht për prodhimin e viçave për majmëri dhe qumështi i të cilave nuk është i destinuar për konsum njerëzor, ose për përpunimin e nënprodukteve të qumështit. Këtu përfshihen lopët në fund të laktacionit, lopët që pas përfundimit të laktacionit mbahen në kushte të mira për majmëri dhe therje.

Dosat për mbarështim me peshë 50 kg e më shumë përfshijnë dosat që peshojnë 50 kg e më shumë, që janë të destinuara për mbarështim, pavarësisht nëse ato kanë pjellë ose jo. Përfshihen dosat e zgjedhura për therje.

Derra të tjerë përfshijnë derrat prej 20-50 kg, derrat për majmëri mbi 50 kg dhe harçat për riprodhim me peshë të gjallë mbi 50 kg.

Shpendët. Ndarja e shpendëve është e lidhur me qëllimin e rritjes: Brojler janë zogj të destinuar për majmëri; Pulat për vezë janë pulat që kanë filluar të bëjnë vezë, për konsum ose për çelje. Janë përfshirë edhe zogjtë që janë duke u rritur, edhe pse ende nuk e kanë arritur moshën për bërjen e vezëve, në qoftë se ata janë strehuar si pula për vezë. Po ashtu, janë përfshirë edhe zogjtë e zgjedhur për therje dhe gjelat për riprodhim të pulave për vezë; Zogjtë, pulat dhe gjelat e tjerë, përfshijnë shpendët që nuk janë të listuara në kategorinë e brojlerëve ose të pulave për vezë;

Pula dhe gjela deti, përfshihen zogjtë një ditësh. Përfshijnë shpendët meshkuj dhe femra Patat dhe rosat përfshijnë shpezët meshkuj dhe femra; Shpendë të tjera përfshijnë pulat afrikane, pëllumbat, etj.

Numri i koshereve të bletëve i referohet numrit të koshereve që janë të zëna nga bletët dhe që mbahen për prodhimin e mjaltit. Secila koloni bletësh është regjistruar si një koshere, pavarësisht nga natyra dhe lloji i zgjoit.

Forcat e punës

Fuqia punëtore e NjEB paraqet të gjithë personat që kryejnë punë, gjatë vitit bujqësor (30 shtator 2011 – 31 Tetor 2012 dhe kontribuojnë në aktivitetin bujqësor dhe blegtoral.

Njësia e Punës Vjetore (NjPV) nënkupton punësimin ekuivalent me punësimin me orar të plotë, d.m.th gjithsej orët e punës, të pjesëtuara me mesataren e orëve të punës gjatë vitit, në punë me orar të plotë, brenda vendit. Me orar të plotë do të thotë orët minimale të kërkuara me dispozitat kombëtare, që i rregullojnë kontratat e punësimit. Si orë minimale janë marrë 1 800 orë pune (225 ditë pune, nga tetë orë në ditë).

Ditë të plota pune

Dita e plotë e punës: konsiderohet dita e zakonshme e punës për personat që punojnë me kohë të plotë, në mënyrë të përhershme 8 orë/ditë.

Punëtor me kohë të plotë

Punëtorët e punësuar me kohë të plotë janë personat të cilët kanë punuar në NjEB çdo javë, gjatë periudhës referuese. Kohëzgjatja përfundon në ditën e referencës së vrojtimit, pavarësisht nga kohëzgjatja e javës së punës.

Punëtor sezonal

Konsiderohen personat të cilët nuk kanë punuar me kohë të plotë në NjEB gjatë periudhës referuese.

Aktivitete të tjera fitimprurëse

Çdo aktivitet tjetër përveç “punë bujqësore” të NjEB-së i kryer kundrejt një pagese (përfshihen: rrogat, përfitimet ose pagesa përfshirë këtu pensionet, ndihmat sociale apo te ngjashme pasi nuk i korrespondojnë një aktiviteti.